



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

RAPORTI VJETOR

2006

DHE

SYNIMET KRYESORE TË PUNËS

PËR VITIN

2007

RAPORTI VJETOR 2006 DHE SYNIMET KRYESORE TË PUNËS PËR 2007

Publikuar nga: Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës
Adresa:
Rr. Sami Frashëri, nr.4, kati IV, Tiranë, Shqipëri.
Tel./Fax.: +355 4 234 497
Web: www.caa.gov.al
E-mail: competition@caa.gov.al

Përkthyer nga: Koço Bendo

Dizajn nga: MOB_Design & Printing Support

Shtypur nga:  Afërdita 2006



gtz

Mbështetur nga: Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunimin
Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) në kuadër të Projektit të
GTZ-së "Mbështetje për Integrimin Europian".

Përmbajtja:

	Fjala e Hyrjes	5
I.	Zhvillimet kryesore në fushën e konkurrencës	7
II.	Politika Kombëtare e Konkurrencës	9
III.	Organizimi dhe funksionimi i Autoritetit të Konkurrencës	10
IV.	Çështjet e ndjekura në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”	14
V.	Integrimi Evropian, Advokatia e Konkurrencës dhe Përafrimi i Legjislacionit.	20
VI.	Veprimtaria ekonomike e Autoritetit të Konkurrencës	27
VII.	Bashkëpunimi me institucionet dhe entet rregullatore	29
VIII.	Synimet kryesore të punës për vitin 2007	30



Fjala e Hyrjes

Prof. As. Dr. Lindita Milo (Lati)

Kryetare

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2006 është realizuar sipas angazhimeve për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” si dhe të gjithë kuadrit ligjor që rregullojnë aktivitetin e një institucioni të pavarur në Republikën e Shqipërisë. Ky institucion e koncepton funksionimin e tij si nxitës dhe avokat i konkurrencës dhe i interesave të konsumatorit, me synimin final që tregu të gjenerojë zhvillim.

Nëpërmjet procedurave të monitorimit, studimit dhe hetimit, Autoriteti i Konkurrencës ka ndjekur me vëmendje zhvillimet në disa tregje duke u përqëndruar në evidencat mbi aspektet e deformimeve të konkurrencës në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Si rrjedhojë janë marrë vendimet përkatëse apo janë dhënë rekomandimet për aktorët e tregut, duke synuar vendosjen e konkurrencës në tregjet e cënuara.

Miratimi i dokumentit të Politikës së Konkurrencës nga Komisioni i ri i Konkurrencës shënon realizimin e detyrimit që i ngarkon ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në të njëjtën kohë edhe të përcaktimit të një strategjie afatshkurtër të planit të veprimeve të Autoritetit të Konkurrencës.

Ndër çështjet kryesore që ka ndjekur Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2006, sipas kuadrit ligjor në fushën e konkurrencës, veçojmë hetimin e thelluar për abuzimin potencial me pozitën dominante në tregun e telefonisë së lëvizshme; hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në Tregun e Sigurimeve dhe konkretisht në sherbimet e Sigurimit të Përgjegjësive ndaj Palëve të Treta Kartoni Jeshil dhe Sigurimin Kufitar dhe TPL-në e brendshme) si dhe një sërë përqëndrimesh (shitje-blerje aksionesh) kryesisht në sektorin bankar.

Autoriteti i Konkurrencës ka qenë aktiv në marrëdhëniet me institucionet qendrore dhe entet rregullatore duke formalizuar nëpërmjet memorandumeve të mirëkuptimit shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin për zbatimin konkret të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” si dhe të ligjeve respektive të tyre.

Gjatë vitit 2006 Autoriteti i Konkurrencës ka qenë pjesë integrale e procesit të Stabilizim-Asociimit, duke u përfshirë në hartimin e Planit të Veprimeve për Zbatimin e Rekomandimeve të Partneritetit Evropian, si dhe në Planin Kombëtar të Përafimit të Legjislacionit. Autoriteti ka plotësuar angazhimet e marra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian dhe ka raportuar progresin e shënuar në fushën e konkurrencës.

Sa i përket bashkëpunimit rajonal, mund të theksojmë se Autoriteti i Konkurrencës ka marrë pjesë në mënyrë aktive në thellimin e bashkëpunimit në rrjetin rajonal të Autoriteteve të Konkurrencës dhe ky bashkëpunim konkludoi me organizimin e konferencës së përbashkët ndërkombëtare për çështjet e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore. Konferenca u organizua në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe me mbështetjen e projektit CARDS dhe GTZ-në. Në të marrën pjesë përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Konkurrencës në Komisionin Evropian, OECD, autoritetet homologe të vendeve të rajonit etj.

I. Zhvillimet kryesore në fushën e konkurrencës.

Gjatë vitit 2006 aktiviteti i Autoriteti i Konkurrencës është përqëndruar në zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” duke u mbështetur në tre shtylla kryesore që përcaktojnë mbrojtjen e konkurrencës: abuzimin me pozitën dominuese; marrëveshjet e ndaluara në formën e karteleve dhe bashkimet ose përqëndrimet e ndër-marrjeve.

Autoriteti i Konkurrencës ka vazhduar punën për hetimin e thelluar në fushën e telefonisë celulare duke zhvilluar një volum të madh hetimi mbi abuzimin potencial me pozitën dominuese të operatorëve që veprojnë në këtë treg. Autoriteti ka informuar Kuvendin dhe në mënyrë specifike komisionin parlamentar “Për hetimin e monopolit në telefoninë celulare” për fazat e hetimit dhe ka ofruar sipas kërkesës së Komisionit informacionet që dispononte.



Autoriteti i Konkurrencës hapi një hetim paraprak me inisiativën e tij edhe në sektorin financiar, më saktësisht në tregun e sigurimeve. Në zbatim të Ligjit 9121, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës ka konstatuar se (i) tregu i sigurimeve për “Përgjegjësinë Ndaj Palëve të Treta” (TPL) nuk është plotësisht i liberalizuar, (ii) koordinimi i sjelljes së operatorëve çon në fiksimin e çmimeve të policave të sigurimit të detyrueshëm, zbatimit të marrëveshjeve eksklusive apo përzgjedhëse sipas produkteve të caktuara (TPL, Polica e Sigurimit Kufitar, Kartoni Jeshil) dhe (iii) tregu i sigurimeve për TPL-në është i deformuar dhe me kufizime të konkurrencës. Për këto arsye, Autoriteti i Autoritetit të Konkurrencës ka vendosur hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në Tregun e Sigurimeve dhe konkretisht në shërbimet e TPL-se (Kartoni Jeshil, Sigurimin Kufitar dhe TPL-në e brendshme).

Gjithashtu Autoriteti i Konkurrencës ka notifikuar një sërë përqëndrimesh, në mënyrë të veçantë në sektorin bankar si ai i shitjes së aksioneve të Bankës Kombëtare Tregtare të Çalik-Seker Consortium; përqëndrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së aksioneve të Emporiki Bank nga shoqëria “Credit Agricole S.A”, përqëndrimin nëpërmjet shitjes së 80 për qind të aksioneve të Bankës Italo-Shqiptare të Banka San Paoli Imi etj. Autoriteti i Konkurrencës

ka ndjekur me vëmendje të gjitha zhvillimet në sektorin financiar, për të monitoruar në vijimësi praktikat anti-konkurrese.

Në qershor të vitit 2006, Autoriteti i Konkurrencës në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe me mbështetjen e projektit CARDS dhe GTZ-së organizoi në Tiranë një konferencë ndërkombëtare: "Politikat e Konkurrencës dhe Ndihmës Shtetërore në kontekstin e Pranimi në Bashkimin Evropian",. Në konferencë u trajtuan çështje të rëndësishme të politikës së konkurrencës dhe të përqasjes së eksperiencave të rajonit me ato të Bashkimit Evropian në fushën e konkurrencës. Gjithashtu, konferenca shërbeu si një urë bashkëpunimi jo vetëm me autoritetet rajonale të konkurrencës, por edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Konkurrencës në Komisionin Evropian dhe ekspertë të njohur në këtë fushë.

Një paraqitje e aspekteve kryesore të Autoritetit të Konkurrencës jepet në raportin e fundit të progresit të Komisionit Evropian për Shqipërisë. Në raport¹ thuhet se "njëfarë progresi është shënuar në fushën e konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës (ACA) ka miratuar rregullore dhe udhëzime sqaruese mbi kontrollin e përqendrimeve, imunitetin nga gjokat si dhe marrëveshjet horizontale dhe vertikale. Gjithashtu ka filluar të vlerësojë

shkrirjet dhe blerjet që i njoftohen. Për sa i përket vënies në zbatim, ACA po procedon me dy dosje të mëdha, në lidhje me respektivisht telefoninë celulare dhe sigurimin e makinave në pikë-kalimet kufitare

Progres është bërë në funksionimin e ACA-s. Anëtarët e stafit janë trajnuar dhe takime rajonale për rritjen e sensibilizimit janë mbajtur për komunitetin e biznesit. Megjithatë, ende s'është e qartë deri në çfarë shkalle Autoriteti i Konkurrencës mund të punojë i pavarur. Shumica e stafit është rekrutuar së fundmi dhe kështu që janë të papërvojë, dhe mungesa e burimeve do të thotë se objektivat për plotësim me staf, nuk janë përmbushur. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për përmirësimin e efikasitetit të kontrollit të konkurrencës. Shqipëria ka ndër marrë angazhime të mëdha në këtë fushë në kuadrin e MSA-së. Përgatitjet në këtë fushë po lançohen".



¹ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, Tetor 2006, fq. Teksti është marrë sipas përkthimit zyrtar të Ministrisë së Integritimit

II. Politika Kombëtare e Konkurrencës

Në zbatim të nenit 24, pika a, Komisioni i Konkurrencës me vendim nr. 43 datë 28.12.2006 miratoi dokumentin e Politikës Kombëtare të Konkurrencës.



Ky është dokumenti i parë i politikës së konkurrencës në Shqipëri dhe është përgatitur duke u bazuar në ekperiencën e ngjajshme të vendeve të rajonit që janë disa etapa më përpara në procesin e integritimit evropian, (si për shembull Kroacia, Bullgaria, Rumania etj), si dhe në vecoritë e zhvillimeve në kulturen e konkurrencës si dhe infrastrukturën ligjore në Shqipëri.

Duke marrë parasysh këto veçori, Autoriteti i Konkurrencës synoi që dokumenti i Politikës Kombëtare të Konkurrencës të ishte gjithëpërfshirës. Për këtë qëllim, ky dokument iu nënshtrua një diskutimi dhe shkëmbimi mendimesh me të gjithë palët e interesit (aktorët potencial në treg) të tillë si: ministrinë dhe entet rregullatore, komuniteti i biznesit, shoqatat e konsumatorit, studiot ligjore etj., duke reflektuar opinionet e tyre në këtë dokument.

Politika e konkurrencës përfaqëson vizionin afatshkurtër dhe afatmesëm i mbrojtjes së konkurrencës në Shqipëri.

Në të pasqyrohen drejtimet kryesore të punës së Autoritetit të Konkurrencës për t'ju siguruar ndërmarrjeve të sektorit privat dhe publik, mundësitë që të ushtrojnë lirisht mbi baza të një konkurrence të lirë, efektivë e të ndershme, aktivitetin e tyre ekonomik.

Politika e konkurrencës synon që të parandalojë aktorët e tregut të abuzojnë me pozitën dominuese, të lidhin marrëveshje që kanë si pasojë fiksimin e çmimeve ose krijimin e një strukture tregu ku konkurrentët bashkohen (me anë të përqendrimit) duke deformuar konkurrencën në treg.

Një objektiv shumë i rëndësishëm i politikës së konkurrencës është rritja e mirëqenies ekonomike të shoqërisë. Duke zhvilluar rritjen e konkurrueshmërisë, duke siguruar rregulla të barabarta loje në treg; duke nxitur evolucionin teknologjik; duke rritur mundësitë për zgjedhje dhe cilësinë e produkteve e shërbimeve dhe duke arritur potencialisht në ekuilibra tregu që presupozojnë të realizojnë çmime sa më reale. Në këtë kontekst, politika e konkurrencës përbën një faktor të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit.

Gjithashtu, duke synuar rritjen e qëndrueshme të konkurrueshmërisë në ekonominë e vendit, politika e konkurrencës mund të japë një kontribut mjaft të rëndësishëm në përmirësimin e treguesve makroekonomikë si: në

nivelin e përgjithshëm të çmimeve, në nivelin e punësimit dhe në rritjen ekonomike.

Politika e konkurrencës, së bashku me politikat monetare, fiskale dhe ato tregtare, është konsideruar si guri i katërt i themelit të politikave publike . Kjo bën të nevojshme që parimet kryesore të saj duhet të mbahen parasysh nga institucionet e ndryshme publike që hartojnë dhe vënë në zbatim të politika të tjera ekonomike, me qëllim harmonizimin e objektivave të tyre me ato të politikës së konkurrencës, duke realizuar në këtë mënyrë qëllimin përfundimtar të punës së qeverisë që është rritja e mirëqenies së qëndrueshme.

Politika e Konkurrencës është e lidhur ngushtë edhe me politikën e ndihmës shtetërore ndaj dhe në hartimin e politikës së ndihmës shtetërore duhet të mbahen parasysh rëndësia e krijimit të kushteve të barabarta për ndërmarrjet me qëllim promovimin e konkurrencës.

Politika e konkurrencës duhet patur parasysh në hartimin e strategjive të enteve rregullatore për sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe për këtë merr një rëndësi mjaft të madhe bashkëpunimi me Entet Rregullatore.

III. Organizimi dhe funksionimi i Autoritetit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës është organ publik, i pavarur në kryerjen e detyrave të veta. Veprimtaria e tij kohore është e shkurtër pasi ka filluar të funksionojë më 1 Mars 2004. Puna e Autoritetit të Konkurrencës mbështetet në ligjin nr. 9121, Datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Qëllimi i ligjit është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, si një e mirë publike.

Autoriteti i Konkurrencës nga pikëpamja organizative përbëhet nga Komisioni dhe Sekretariati. Komisioni përbëhet nga katër anëtarë dhe kryetari.

III.1. Komisioni i Konkurrencës

Komisioni i Konkurrencës është organ kolegjal, i përhershëm me mandat pesëvjeçar, i drejtuar nga Kryetari. Komisioni i Konkurrencës ka të gjitha kompetencat e nevojshme për marrjen e vendimeve me nismën e tij, për çështje që kufizojnë, pengojnë apo deformojnë konkurrencën në treg, si për ndërmarrjet private ashtu dhe për ato publike, si dhe propozimin e mjeteve të nevojshme për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Gjatë vitit 2006, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi mbi ndryshimin e kriterëve të përzgjedhjes së antarëve të Komisionit të

Konkurrencës(reflektuar në nenin 20 pika c të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”) si dhe përbërjen e Komisionit të Konkurrencës.

Një zhvillim i rëndësishëm për Autoritetin e Konkurrencës ishte zgjedhja e Kryetarit të Komisionit të Konkurrencës më 17 korrik 2006, rreth 14 muaj pasi kishte dhënë dorëheqjen kryetari paraardhës. Gjatë periudhës së mungesës së kryetarit, detyrat e Tij në bazë të nenit 25 të ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë ushtruar nga zëvendëskryetari.

Edhe gjatë vitit 2006 një nga vendet e antarit të Komisionit të Konkurrencës mbeti vakant për arsye të mungesës së propozimit nga ana e Presidentit të Republikës, cilësuar në nenin 21, pika a, e ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Autoriteti i Konkurrencës i është drejtuar disa herë Presidentit për plotësimin e Komisionit të Konkurrencës me antarin e pestë, pasi në këtë mënyrë sigurohet një vendimmarrje më e plotë e Komisionit, por deri më tani nuk ka patur asnjë zhvillim.

Një ndryshim i rëndësishëm në fushën e legjislacionit që lidhet me organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës, ishte heqja e kompetencës së Komisionit të Konkurrencës për të miratuar strukturën organizative të Autoritetit të Konkurrencës, siç përcaktohej në

“shkronjën “b”, të nenit 24, të ligjit nr. 9121, date 28.7.2003, “Per mbrojtjen e konkurrencës“.

Me miratimin e ligjit 9584, datë 17.07.2006² “Për pagat, shperblimet dhe strukturat në institucionet e pavarura te krijuara, me ligj”, në nenin 15, shfuqizohet “shkronja “b”, e nenit 24, të ligjit nr. 9121, date 28.7.2003, “Per mbrojtjen e konkurrencës“, dhe struktura e Autoritetit të Konkurrencës përcaktohet me vendim të Kuvendit(neni 10³ i ligjit 9584, datë 17.07.2006).

Ky ndryshimi ka shkaktuar inkoherencë mes miratimit të ligjit të buxhetit (në lidhje me numrin e punonjësve) për vitin 2007 dhe strukturës së re të Autoritetit të Konkurrencës, e cila nuk është miratuar ende nga Kuvendi, duke sjellë vonesa në zbatimin e plotë të angazhimeve ligjore dhe të planit të veprimeve të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2007.



Komisioni i Konkurrencës

² Fletore zyrtare nr 84, datë 9-08-2006

³ Struktura dhe organika e institucioneve kushtetuese miratohet me vendim te Kuvendit ne baze te numrit te miratuar ne zbatim te buxhetit te shtetit per cdo institucion.

III.2. Sekretariati

Sekretariati drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili zgjidhet nga Komisioni. Punonjësit e Sekretariatit gëzojnë statusin e nëpunësit civil. Inspektorët e Sekretariatit kryejnë hetime administrative, sipas Kodit të Procedurave Administrative, ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Sikurse është nënvizuar edhe nga vlerësimet e Komisionit Evropian, forcimi i kapaciteteve administrative ka qënë në vëmendje të Autoritetit të Konkurrencës, si nga pikëpamja e numrit dhe strukturës, ashtu edhe e formimit të tyre profesional. Në tërësi, këta elementë kanë qënë të pamjaftueshme për të realizuar detyrat e ngarkuara nga ligji. Struktura e Sekretariatit të Konkurrencës gjatë vitit 2006 përbëhej nga një numër total personash prej 15 vetësh nga të cilët vetëm 7 persona mbulonin në mënyrë të drejtëpëdrejtë fushat e zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Në zbatim të detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, Kuvendi dhe Qeveria kanë shprehur dhe konkretizuar mbështetjen e tyre për Autoritetin e Konkurrencës nëpërmjet miratimit të burimeve shtesë njerëzore dhe financiare për vitin 2007. Konkretisht, Autoritetit të Konkurrencës, gjatë vitit të ri buxhetor i janë shtuar 15

vetë, nga të cilët 80 për qind përbëjnë staf ekspertësh.

Sekretariati, gjatë vitit 2006, përbëhej nga tre drejtori, si vijon:

III.2.1 Drejtoria e Analizave dhe Hetimit Të Tregut

Drejtoria e Analizës dhe Hetimit të Tregjeve, realizon monitorimin, studimin dhe hetimin e tregut në këndvështrimin e mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe rregulloreve të miratuara nga Komisioni i Konkurrencës.



Ilustrim

Drejtoria në analizën e zhvillimeve në treg mbështetet në tre shtyllat kryesore të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” si abuzimi me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluara dhe përqëndrimet/shkrirjet e ndërmarrijeve.

Gjatë vitit 2006 nga kjo drejtori janë zhvilluar studime për strukturën e tregut, nëpërmjet kryerjes së analizave ekonomiko-financiare dhe he-

time për identifikimin e praktikave anti konkurruese, marrëveshjeve kartele që dëmtojnë/ kërcënojnë/rrezikojnë të shtrembërojnë konkurrencën apo të krijojnë ose të forcojnë pozitën dominuese. Gjithashtu kjo drejtori kryen, analiza për vlerësimin e efekteve ekonomike që rrjedhin nga bashkimet apo nga dhënia e të drejtës ekskluzive.

III.2.2 Drejtoria e Çështjeve Juridike

Drejtorja e Çështjeve Juridike ushtron kompetencat e saj duke zbatuar strategjinë e Autoritetit të Konkurrencës për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregulloren e institucionit dhe akteve të tjera nënligjore.

Drejtorja e Çështjeve Juridike studion legjislacionin që bie ndesh me konkurrencën dhe analizon informacionet mbi pengesat juridike që kufizojnë dhe deformatojnë konkurrencën në treg, si dhe i propozon Komisionit ndryshimet përkatëse ligjore dhe nënligjore për arritjen e një konkurrence efektive, si dhe interpretimin ose bazueshmërinë ligjore të akteve normative në përgjithësi dhe atyre të AK-së në veçanti.



Një detyrë parësore e kësaj Drejtorie është përkthimi në gjuhën juridike të

Studimeve dhe veshja e analizave ekonomike me “mbulesë” juridike dhe me mburjtja me argumente të kësaj disipline.

III.2.3 Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve

Drejtorja e Burimeve Njerëzore ka realizuar rekrutimin e specialistëve të motivuar sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të vendeve të punës në Autoritetin e Konkurrencës. Me mbështetjen e projektit CARDS, janë realizuar disa kualifikime, në mënyrë që të mund të përballoheshin detyrimet e ligjit dhe zhvillimet në treg në fushën e konkurrencës. Rekrutimi i stafit të kualifikuar është bërë sipas kriterëve dhe procedurave të nenit 10 të ligjit Nr 8549, datë 11.11.1999 “Statuti i Nëpunësit Civil”.

Për periudhën korrik 2004 -- korrik 2006, Autoriteti i Konkurrencës është mbështetur me asistencë teknike nga projekti CARDS dhe në këtë kuadër janë realizuar një sërë trajnimesh të brendshme të stafit nga ekspertët e projektit dhe vizita studimore pranë institucioneve homologe.

Drejtesit dhe specialistët e Autoritetit të Konkurrencës kanë marrë pjesë në një sërë aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare, si seminare,

workshope, konferenca etj., ku kanë përfituar eksperiencë të vlefshme në fushën e konkurrencës.

Efektiviteti i investimeve në trajnimet e stafit është i ulët për shkak të lëvizjeve të shpeshta të stafit gjatë periudhave të mëparshme. Për më tepër, vetë institucioni ka më pak se tre vjet eksperiencë.

Një drejtim tjetër i punës së kësaj drejtorie është mbulimi i veprimtarisë financiare të Autoritetit dhe mbajtja e përgjegjësisë së plotë për të gjitha problemet që kanë të bëjnë me administrimin e fondeve të buxhetit, konform legjislacionit financiar të Shtetit Shqiptar.

Buxheti vjetor për financimin e veprimtarisë së Autoritetit, i cili përbën zë më vete në buxhetin e shtetit, miratohet nga Kuvendi. Të ardhurat që krijohen në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, përfshirë dhe të ardhurat nga gjobat, derdhen në buxhetin e shtetit.

Kjo Drejtori, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera përgatit projekt-buxhetin e Autoritetit të Konkurrencës për miratim, mban llogaritë e shpenzimeve dhe të të ardhurave faktike, kryen analizat e përdorimit të fondeve buxhetore në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.

IV. Çështjet e ndjekura në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Në dispozitat e Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” janë shprehur qartë, procedura të hollësishme për investigimin e marrëveshjeve, abuzimin me pozicionin dominues apo kontrollin e përqendrimeve, si dhe gjobat e sanksionet në rastin e shkeljes së këtij ligji.

Çështjet kryesore që ka ndjekur Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” kanë qënë:

IV.1. Abuzimi me pozitën dominuese

Ligji për mbrojtjen e konkurrencës ndalon abuzimin me pozitën dominuese dhe jo pozitën dominuese në vetvete.

Ligji ndalon çdo abuzim nga një ose më shumë ndërmarrje me pozitë dominuese në treg, në mënyrë të veçantë në rastet e vendosjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të blerjes ose të shitjes, ose të kushteve të tjera të padrejta të tregtimit.

Autoriteti i Konkurrencës është në proces të hetimit të thelluar për abuzimin potencial me pozitën dominuese



në tregun e telefonisë së lëvizshme, të ndërmarrë me nismën e Komisionit të Konkurrencës në 6 mujorin e dytë të vitit 2005. Palët e përfshira në këtë hetim janë dy kompanitë që veprojnë në tregun shqiptar, AMC dhe Vodafon. Grupi i punës për hetimin e kësaj çështjeje, ka kërkuar bashkëpunim për sigurimin e të dhënave jo vetëm nga palët në hetim por edhe nga institucionet publike të lidhura me këtë çështje dhe kryesisht me entin rregullator të sektorit përkatës.

Siç është informuar në raportin e vitit 2005, shoqëritë që janë objekt i procedurave të hetimit, kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me kërkesën e Autoritetit për sigurimin e të dhënave nga ana e tyre..AMC nuk vuri në dispozicion të Autoritetit të dhënat e kërkuara. Në këto kushte Komisioni i Konkurrencës zbatoi alternativën e vetme ligjore, vendosjen e gjobës ndaj shoqërisë AMC në vleftën e 160 milionë lekë, sanksion i parashikuar në nenin 73, të Ligjit nr. 9121 datë 21.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Shoqëria AMC e ka ankimuar këtë vendim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë - Tiranë. Gjykata ka rrëzuar padinë e shoqërisë AMC duke konfirmuar edhe një herë vendimin e Komisionit të Konkurrencës për shkelje procedurash nga ana e shoqërisë AMC.

Por deri më sot, kjo gjobë nuk është vjelë nga Policia Tatimore, e cila ka detyrimin ligjor për ekzekutimin e saj, bazuar në nenin 80 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Autoriteti i Konkurrencës i është drejtuar disa herë zyrtarisht Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve për ekzekutimin e këtij vendimi.

Ndaj vendimit të Komisionit të konkurrencës për hetim të thelluar, shoqëria AMC ka ngritur padi pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Në këtë proces Gjykata ka rrëzuar pretendimet e palës paditëse duke i dhënë të drejtë Komisionit të Konkurrencës në vendimmarrjen e tij. Çështja është në proces apelimi nga shoqëritë.

Autoriteti i Konkurrencës ka informuar për procedurat dhe rezultatet e pjesshme të hetimit edhe Komisionin Hetimor Parlamentar “Për Hetimin e tregut monopol të telefonisë celulare dhe përgatitjen e rekomandimeve për eliminimin e kësaj shtate monopol”. Sugjerimet e Autoritetit të Konkurrencës në përgjithësi janë marrë parasysh nga Komisioni Parlamentar i Kuvendit dhe janë pasqyruar në raportin përfundimtar.

Hetimi i thelluar në fushën e telefonisë së lëvizshme është drejt përfundimit dhe do t'i kalojë për vendimmarrje Komisionit të Konkurrencës.

IV.2. Marrëveshjet e ndaluara

Një nga shtyllat e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” janë marrëveshjet ndërmjet konkurrentëve të cilat kufizojnë konkurrencën. Këto lloj marrëveshjesh konsiderohen të ndaluara pasi kanë të bëjnë me praktikat anti-konkurrese, veçanërisht ato marrëveshje që kanë si objekt të tyre ose si efekt, fiksimin e çmimeve, ndarjen e tregut sipas territorit dhe fiksimit të çmimeve ose volumit të shitjeve.

Autoriteti i Konkurrencës, duke marrë shkas nga një kërkesë e Autoritetit Mbikqyrjes Financiare (AMF) lidhur me licensimin nga ana e saj të Agjencisë Sigurimit të Automjeteve (ASA), ndërmori një studim mbi vlerësimin e konkurrencës në tregun e sigurimeve dhe në veçanti për policat e sigurimit të detyrueshëm.



Tregu i sigurimeve vlerësohet si treg i rregulluar nga Autoriteti i Mbykqyrjes së Sigurimeve (aktualisht Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare). Enti rregullator përkatës, nëpërmjet procedurave të lincensimit dhe të mbikqyrjes së funksionimit të operatorëve që funksionojnë në këtë treg, synojnë mbrojtjen e interesave publike dhe krijimin e një mjedisi konkurrues. Për çështjet që lidhen me mbrojtjen e konkurrencës nga pikëpamja e kontrollit të sjelljeve jokonkurrese (marrëveshjet kartel, abuzimi i pozitës dominuese) dhe kontrollit të bashkimeve mes subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike, pavarësisht nga fakti nëse operojnë në sektorë të rregulluar ose jo, vepron Autoriteti i Konkurrencës.

Në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, AK ndërmori një studim për vlerësimin e tregut të sigurimeve dhe në veçanti lidhur me ofrimin e shërbimit për policat e sigurimit të detyrueshëm. Në përfundim të studimit të kryer, u konkludua se tregu i sigurimeve nuk është plotësisht i liberalizuar. Shteti ruan ende kontrollin mbi çmimet vetëm në sigurimin e detyrueshëm motorrik, siç është përgjegjësia ndaj palëve të treta (TPL) për përdoruesit e mjeteve motorrike. Përveç kësaj, kufizimi i konkurrencës vjen edhe si rezultat i marrëveshjeve apo praktikave të bashkërenduara, koordinimit të sjelljes së shoqërive që çojnë në fiksimin e çmimeve të policave të sigurimit të detyrueshëm, për produktet

TPL e brendshme, polica e sigurimit kufitar dhe kartoni jeshil. Konkretisht, Autoriteti ka përfunduar procedurën e hetimit paraprak dhe me Vendim të Komisionit është në ndjekje të procedurës së hetimit të thelluar.

IV.3. Përqëndrimet

Shtylla e tretë e ligjit “Për mbrojtjen e Konkurrencës” lidhet me procedurat e përqëndrimeve, të cilat përbëjnë edhe një nga drejtimit kryesore të aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës. Forma të përqëndrimit janë bashkimi, shkrirja e dy ndërmarrjeve, përtimi i kontrollit të drejtpërdrejtë nga një ndërmarrje mbi një tjetër, apo krijimi i një ndërmarrje të përbashkët, që vepron si e pavarur ekonomikisht, nga ndërmarrjet që e krijuan atë. Përqëndrimi është pjesë e ristrukturimit industrial dhe shihet si i nevojshëm për t’ju përgjigjur sfidave të ekonomisë globale.

Politika e kontrollit të përqëndrimeve duhet të kontribuojë për të nxitur reformat strukturore dhe ekonomike në Shqipëri drejt konsolidimit të ekonomisë së tregut. Nëpërmjet kësaj politike synohet mbetja e një numri të mjaftueshëm të ndërmarrjeve në treg, të cilat sigurojnë një konkurrencë efektive dhe potencialisht çmime të ulta.

Bazuar në eksperiencat e deritanishme, Autoriteti i Konkurrencës ka kri-

juar praktika të konsoliduara në fushën e zbatimit të kuadrit ligjor⁴ në kontrollin e përqëndrimeve tëndërmarrjeve. Me anë të kontrollit të përqëndrimeve, Autoriteti i Konkurrencës ndalon ato përqëndrime që rrezikojnë të krijojnë ose të forcojnë pozitën dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, duke e kufizuar ndjeshëm konkurrencën efektive të tregut.

Viti 2006 u karakterizua nga një zhvillim dinamik i tregut bankar. Kjo dinamikë shprehet në ndryshimet strukturore dhe të pronësisë së ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun bankar. Për pasojë, gjatë këtij viti janë shtuar ndjeshëm aplikimet për njoftim të përqëndrimeve të bankave pranë Autoritetit të Konkurrencës duke dhënë sinjalet se tregu po zhvillohet drejt konsolidimit të bankave dhe bashkimit të tyre.

Për të gjitha rastet e shqyrtuara, Autoriteti ka bashkëpunuar me Depar-

17

Ilustrim



⁴ Procedura për kontrollin e përqëndrimeve, ligji nr 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(nenet 53-63).

tamentin e Mbikqyrjes së Bankës së Shqipërisë, si autoriteti rregullator në tregun bankar.

Rastet e trajtuara gjatë viti janë:

a) Banka Italo-Shqiptare—San Paolo IMI

Në shkurt të vitit 2006, Autoriteti i Konkurrencës, shqyrtoi njoftimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet transaksionit të shitblerjes së 80% të aksioneve të Bankës Italo-Shqiptare te kompania San Paolo IMI s.p.a. Qeveria Shqiptare dhe shoqëria Capitalia, që kishin respektivisht nga 40 % të aksioneve në Bankën Italo Shqiptare, vendosën t'ia shesin këto aksione kompanisë San Paolo IMI S.p.a. Ky transaksion realizoi një zëvendësim të pronësisë së Bankës Italo Shqiptare nga kompania San Paolo IMI S.p.a si fituesi i tenderit publik të organizuar që në vitin 2005 nga Qeveria Shqiptare.



Sipas vlerësimit të Autoritetit të Konkurrencës, ky përqëndrim nuk kishte efekte negative në lidhje me konkurrencën në tregun e produktit përkatës apo të tregut gjeografik, ndaj dhe Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqëndrimin e njoftuar.

b) Banka Kombëtare Tregtare- Çalik Seker Yatirim Konsorsiyum A.S

Autoriteti i Konkurrencës ka shqyrtuar njoftimin për përqëndrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 60% të aksioneve nga Banka Kombëtare Tregtare, tek kompania turke Çalik Seker Yatirim Konsorsiyum A.S.

Në analizën e të dhënave të siguruar nga palët, rezultoi se përqëndrimi nuk sillte ndonjë ndryshim në strukturën e tregut bankar ndaj dhe Komisioni autorizoi përqëndrimin e realizuar. Pala blerëse nuk respektoi afatet për njoftimin e përqëndrimit⁵. Komisioni në përputhje me nenin 74 të ligjit, vendosi masën e gjobës prej 2% të xhiros vjetore të vitit paraardhës financiar për blerësin, kompaninë turke Çalik Seker Yatirim Konsorsiyum A.S., e cila kap shumë më 6.5 milion lekë.

Autoriteti i Konkurrencës lidhur me këtë vendim, i kërkoi Policisë Tatimore vjeljen e gjobës pasi sipas ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Policia Tatimore është organi i ngarkuar për ekzekutimin e gjobës.

Kompania Çalik Seker Yatirim Konsorsiyum A.S. e ankimoi vendimin e Komisionit për vendosje gjobe pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata pasi vlerësoi pretendimet e palëve, në muajin dhjetor 2006, rrëzoi padinë e kompanisë Çalik Seker Yatirim Konsorsiyum A.S, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Konkurrencës.

⁵ Mosnjoftimi i një përqëndrimi konsiderohet shkelje e rëndë dhe gjobitet në masën 2-10% të xhiros së vitit financiar paraardhës.

c) Emporiki Bank -Credit Agricole

Autoriteti i Konkurrencës, në muajin shtator 2006 ka shqyrtuar njoftimin për përqëndrimin e realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 71.97% të aksioneve, të Emporiki Bank me qendër në Greqi dhe filialet e saj, të Credit Agricole S.A me qendër në Paris, Francë. Procedura e realizimit të këtij përqëndrimi ka filluar nëpërmjet publikimit të ofertës publike vullnetare nga Credit Agricole S.A.

Duke qënë se Emporiki Bank është e pranishme në tregun shqiptar me anë të filialit të saj, kompania Credit Agricole S.A. për transaksionin e kryer, duhet të njoftonte për të marrë autorizimin për lejimin e përqëndrimit edhe Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës. Procedurat që ndjek Autoriteti i Konkurrencës për kontrollin e përqëndrimeve, janë në përputhje të plotë me procedurat që parashikon legjislacioni evropian. Meqenëse, palët pjesëmarrëse, në këtë transaksion ushtronin veprimtaritë e tyre jashtë territorit të Shqipërisë, ato ishin të detyruara të njoftonin përqëndrimin edhe pranë Komisionit Evropian dhe Bankës Kombëtare të Greqisë.

Autoritetet e mësipërme, duke qënë se e gjetën këtë njoftim në përputhje me legjislacionin përkatës, respektivisht evropian dhe grek, dhanë miratimin e tyre për fitimin e kontrollit nga

Credit Agricole S.A në Emporiki Bank. Komisioni Shqiptar i Konkurrencës në zbatim të ligjit autorizoi përqëndrimin e njoftuar.

d) San Paolo IMI-Intesa spa

Në muajin dhjetor, Autoriteti i Konkurrencës, shqyrtoi njoftimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet Bankës Sanpaolo IMI S.p.a nga Banka Intesa S.p.a.

Palët pjesëmarrëse në këtë transaksion ushtrinë veprimtarinë e tyre në tregun bankar italian, por duke qënë se San Paolo IMI S.p.a është zotëruese e 80% të aksioneve në Bankën Italo Shqiptare ky transaksion iu nënshtrua procedurës së Kontrollit të Përqëndrimeve, të parashikuara në nenet 53-64 të Ligjit. Autoriteti i Konkurrencës e konsideroi këtë transaksion si një zëvendësim pronësie të Sanpalo IMI S.p.a, nga Intesa në BIA, që nuk shkakton ndryshime strukturore në tregun bankar dhe miratoi njoftimin e përqëndrimit.

IV.4. Monitorimi dhe studimi i tregut.

Në përmbushje të misionit të tij, megjithë numrin e kufizuar të stafit, Autoriteti i Konkurrencës, ka ndërmarrë kryerjen e dy studimeve:



- në tregun e energjisë dhe në veçanti për gazin e lëngshëm;
- në tregun farmaceutik.

Qëllimi i këtyre studimeve është vlerësimi i kushteve aktuale të tregut, forcave që veprojnë në të, prirjet e tij, shkalla e respektimit të rregullave të lojës, me synim marrjen e masave të nevojshme për rregullimin në avancë (ex-ante) dhe kontrollin e tij pas veprimit (ex-post).

Autoriteti është në proces shqyrtimi të studimeve të mësipërme për t'i konsideruar si tregje potenciale të monitorimit, analizimit dhe hetimit në të ardhmen.

V. Integrimi Evropian, Advokatia e Konkurrencës dhe Përafrimi i Legjislacionit.

Autoriteti i Konkurrencës mori pjesë në mënyrë aktive në grupin negociator shqiptar për bisedimet zyrtare për nënshkrimin e Marreveshjes së Asociimit-Stabilizimit, e cila u konkretizua me 12 Qershor 2006.

Nga Takimet e zhvilluara të Komitetit BE-Shqiperi në kuadër të Grupit Task-Force dhe atij të 9 të zhvilluara në muajt Qershor (në Bruksel) dhe Dhjetor (në Tiranë) u vlerësua puna e kryer nga ky Autoritet në zbatim të ligjit organik dhe nxitjes së politikave liberalizuese, si politika të cilat çojnë drejt një konkurrence gjithnjë e më efektive dhe të lire në treg. Funkcionimi normal i këtij institucioni u konsiderua në këto takime si një hap përpara drejt përmbushjes së detyrimeve të palet shqiptare në procesin e integritimit evropian. Këto detyra të shprehura në nenet 6, 40, 70, 71 dhe 72 të MSA-së ose 38 e 39 të Marreveshjes së Ndermjetme, kanë të bëjnë pikërisht me ndikimin që sjellin në shkëmbimet tregtare midis KE-së dhe Shqipërisë marreveshjet përmes të cilave pengohet, kufizohet apo deformohet konkurrenca, si dhe abuzimet me pozitën dominuese në treg, etj.

Me hyrjen në fuqi të VKM Nr.463, datë 05.07.2006 "Për zbatimin e Planit Kombëtar të Perditsimit të Legjislacionit", duke u fokusuar në



fushen e Konkurences dhe Ndhimes Shteterore, Nënfusha e Konkurences, u përcaktua si detyre per 6-mujorin e dyte te 2006 perkthimi dhe përshtatja e legjislacionit të konkurrencës me dy rregullore të Acquis Communautaire. Konkretisht Rregullorja e pare eshte ne pershtatje te Rregullores se Keshillit te Evropes nr.1/2003, date 16.12.2002 dhe, e dale nga ky Keshill, ka formen e nje akti ligjor te Bashkimit Evropian, gjithmone ne zbatim te neneve 81 dhe 82 te Traktatit. Kjo Rregullore jep njohuri te gjere te veprimit te Autoritetit Shqiptar te Konkurences me organet homologe te vendeve anetare te BE-se dhe kryesisht me Komisionin evropian te Konkurences ne Bruksel, sidomos per raste te hetimeve te ndersjellta per firma te huaja me veprimtari ne tregjet dhe territorin gjeografik te Republikes se Shqiperise.

Rregullorja e dyte e pershtatur eshte marre si perkthim i Rregullores 773, date 7.04.2004 te Komisionit te Bashkimit Evropian (pra e organit ekzekutiv te BE-se, ose "qeverise" se kesaj strukture konfederative). Kjo rregullore nuk eshte gje tjeter vecse nje "akt-neligjor" ne zbatim te "aktit-ligjor", Rregullores se mesiperme 1/2003, date 16.12.2002. Elementë të të cilave do të përfshihen në një shkalle të caktuar në ligjin vendas të konkurrencës, ose rregulloret e brendshme. Ne kete rregullore, e cila ne dhjetor te vitit të

kaluar u bë pjese e te drejtes të Autoritetit te Konkurences u percaktuan hollesite e veprimtarise se institucionit shqiptar te konkurences ne perputhje me koordinimet e veprimeve te autoriteteve te tjera te vendeve anetare te BE-se ose vendeve kandidate per antaresim. Në te pershkruhen menytrat e veprimit te anketimit dhe te procedimeve me ndermarrjet ose shoqatat e ndermarrjeve, te cilat ushtrojne veprimtarine tyre ne vende ku shtrine fuqine e tyre normative aktet e mesiperme si vende anetare te BE-se ose te cilat jo vetem i njohin por edhe i kane bere te tyret keto akte ne te drejten e tyre juridike.

Autoriteti i Konkurences ka marre pjese ne nje sere trainimesh, konferenca dhe seminare per vendet e Evropes Juglindore, te organizuara nga OCDE-ja, projektet CARDS 2002 ose 2003, Projekti GTZ etj. Ne te gjitha keto takime, përfaqsesit e Autoritetit kanë qene aktive ne diskutime lidhur me çështjet e trajtuara, si dhe kane parashtruar edhe zgjidhjet e rasteve te shqyrtuara nga ky Autoritet, si dhe referime te drejten tone te konkurences.

Autoriteti i Konkurences eshte anetar me te drejta te plota, qe prej vitit 2003, i ICN-se, Rrjetit Nderkombetar te Konkurences ku aderojne shumica e juridiksioneve kompetente te konkurences te vendeve ndryshme te botes. Permes ketij rrjeti Autoriteti

bashkëpunon ngushte edhe me organizata të tjera nderkombetare të perbotshme sikurse janë OBT (Organizata Botërore e Tregtisë), UNCTAD (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtine dhe Zhvillimin). Në këtë mënyrë synohet të arrihet forcimi i bashkëpunimit mbarbotëror dhe arritja e politikave konvergjente të konkurrencës, përmes një dialogu të vazhdueshëm, e të përqendruar. Në këtë kontekst, Autoriteti i Konkurrencës ka qenë vazhdimisht i angazhuar dhe ka dhënë kontributin e tij në përgatitjen e materialeve, në kuadër të studimeve të ndryshme që kryhen nga ky rrjet për çështjet e konkurrencës.

V.1. Puna për përafrimin e legjisllacionit

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2006 ka punuar për të përcaktuar dhe plotësuar të drejtën vendase të konkurrencës me akte të tjera nenligjore të brendshme, të vlefshme për punën e tij të përditshme.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit u përcaktuan detyrimet që merret për Autoritetin në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit në planin e përafrimit të legjisllacionit shqiptar me Acquis Communautaire. Përzgjedhja e akteve normative për përfaqësim në legjisllacionin tonë u bë me keshillimin e përhershëm, marrjen e mendimit dhe asistencën e Programit CARDS (Asistenca Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilitet) 2002 dhe CARDS rajonal 2003, po kështu edhe me përkrahjen e GTZ-së. Detyrimet e Autoritetit të Konkurrencës janë të përfshira në kuadrin e MSA-së në vendim qeverie në Fushën e Konkurrencës dhe Ndihmës Shtetërore dhe me pas në Nenfushën e Konkurrencës.

Sipas këtyre detyrimeve ishte planifikuar që për 6-mujorin e dytë të vitit nga ana e Autoritetit të Konkurrencës të përktheheshin dhe përafroheshin dy rregullore të Bashkimit Evropian. Dhe Autoriteti i Konkurrencës e përfundoi në përputhshmeri të plotë me Planin e Zbatimit të MSA-së, përkthimin dhe



pershtatjen e ketyre dy rregulloreve, të cilat janë kthyer në pjesë të së drejtës së brendshme të konkurrencës dhe të akteve nënligjore në këtë fushë. Përshirja e tyre si pjesë e legjislacionit dytesor për konkurrencën nga ana e Autoritetit, në përputhje me parimet e Bashkimit Evropian, bëjnë të mundur plotësimin gjithnjë e më tepër të kuadrit ligjor në Nenfushen e Konkurrencës dhe funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës si një institucion publik i pavarur në mbrojtje të konkurrencës libre dhe efektive në treg.

Njëkohësisht mbrojtja e Konkurrencës nga ana e Autoritetit në drejtim të legjislacionit është parë edhe në aspektin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimet e dispozitave të nenit 69, pika 2, të Ligjit 9121; të nenit 70 të MSA-së etj., duke dhënë kontributin e tij modest në vlerësimin e shkallës së kufizimit ose të pengimit të konkurrencës që rrjedh nga projekt-aktet ligjore dhe nënligjore të cilat i janë adresuar Autoritetit të Konkurrencës për dhenie mendimi, ose kur vet Autoriteti me nismën e tij ka konstatuar pengime ose kufizime të konkurrencës në akte të ndryshme ligjore ose nënligjore.

Në përputhje me dispozitat e mësipërmë Autoriteti ka kërkuar zyrtarisht nga strukturat përkatëse, që për çdo akt i cili mund të sillte kufizime të konkurrencës, ti kërkohej mendim, ti jepej mundësia të shprehej në lidhje me to dhe keto rekomandime të mer-

reshin në konsideratë, sidomos kur do të kihej të bëhej me akte normative. Nga kjo pikpamje Autoriteti ka kërkuar që të përfshihet në listën e institucioneve të cilave Qeveria ka miratuar kërkimin e mendimit të një akti-nënligjor ose projekt-akti ligjor, gjë që për të cilën nuk ja ka dalë mbanë.

Më konkretisht Autoriteti i Konkurrencës propozoi amendimin e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.4, datë 16.06.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në UKM nr.1, datë 1.01.1996 “Për Prokurimin Publik” pasi sipas pikës 2 të këtij udhëzimi Autoriteti i Konkurrencës ngarkohej me dhenien e konfirmimeve mbi ekskluzivitetin e firmave të ndryshme që mund të tregtojnë mallra ose të marrin persiper kryerje shërbimesh ekskluzive. Një gjë e tillë binte në kundërshtim me ligjin organik të Autoritetit dhe natyrën e punës së tij të percaktuar në 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Autoriteti i Konkurrencës ka dhënë mendime edhe për projekt-ligjin “Për Konkensionet dhe Partneritetin Publik-Privat”. Autoritetit të Konkurrencës është shprehur për problemet që haste në të zbatimi i konkurrencës së lire dhe efektive sipas ligjit 9121. Në pari Autoriteti është shprehur në fund vitit 2005 mbi problemet që krijonte ligji në fuqi 7973, datë 26.07.1995 “Për Konkensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukture” për dispozita që krijonin në

vetvehte pengesa per konkurencen e lire ne fushen e koncensioneve, të cilat jo vetem qe nuk ishin eliminuar ne projekt-ligjin e ri, por ato ishin mbartur qe nga ligji i vjetër. Mosmarrja parasysh e vërejtjeve të Autoritetit nga ana METE (M.Ekonomise, Tregtise dhe Energjise) na detyron qe te kerkojmë mbështetje për marrje parasysh të këshillimeve tona.

Nje detyre tjeter e realizuar nga Autoriteti eshte dhe dhenia e mendimeve te tij edhe per projekt-ligjin e ri " Per Zhvillimin e Turizmit", të cilat janë marrë në konsideratë duke rrezatuar një shëmbull pozitiv në zbatim te Ligjit 9121.

Autoriteti ka dhënë mendime edhe për projekt-vendimin e propozuar prej Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës "Per Miratimin e Procedurave te Notifikimit te kuadrit ligjor tregtar; ekonomik dhe financiar ne Organizaten Boterore te Tregtise". Opinioni i Autoritetit lidhej me eliminimin e nje pike ku behej fjale per dhenie e certifikim ekskluziviteti nga ana e Autoritetit te Konkurences; gje qe binte ndesh me ligjin "Per Mbrojtjen e Konkurences". Kjo gje ishte kundersh-tuar edhe me pare nga ana jone ne udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.4, date 16.06.2005 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne UKM nr.1, date 1.01.1996 "Per Prokurimin Publik".

Autoriteti i Konkurences ka paraqitur pranë gjykatave mbrojtjen e vendimeve të tij në rastet kur ata janë apeluar

nga palët e prekura. Ne kete drejtim do te permendim dy padi te drejtuar kunder Autoritetit nga ana e Albanian Mobile Communication AMC ne lidhje me vendimet e Komisionit te Konkurences. AMC kërkoi deklarim te pavlefshem te hetimit te Thelluar ndaj kesaj firme, si dhe anulimit te gjobes 160 milionë lekë te vendosur ndaj kesaj firme per shkelje te ligjit " Per Mbrojtjen e Konkurences".

Vendimet e gjykatës kanë rrëzuar pretendimin e shoqërisë AMC duke mos cënuar vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës, pavarësisht se ligji "Për mbrojtjen e konkurrencës" është në fazat e para të zbatimit të tij.

Ne lidhje me ecurine e ketyre proceseve Autoriteti ka informuar zyrtarisht edhe Komisionin Parlamentar "Për Hetimin e tregut monopol të telefonisë celulare dhe përgatitjen e rekomandimeve për eleminimin e kësaj situatë monopol" i cili u ngrit per te hetuar ne drejtim te shoqerive AMC dhe Vodafon, qe vepronin ne tregun e Telefonise se Levizshme.

Edhe konsorciumi Calik Konsorsyumi Yatirim A,S apeloj vendimin e Komisionit të Konkurrencës per gjoben mbi njoftimin me vonese të perqendrimit te kryer nga kjo shoqeri ne blerjen e nje pjese te aksioneve te BKT (mbi 60,2 %) si blerese e Kent Bankes ne Turqi.

Edhe ne këtë rast Gjykata e Shkallës së parë nuk cënoi vendimin e Komis-

ionit të Konkurrencës duke konfirmuar procedurat ligjore që kishte ndjekur Komisioni në marrjen e këtij vendimi.

V.2. Advokatia dhe Kultura e Konkurrencës

Krijimi i nje kulture te konkuresces perfshin veprimtarite e ndermarra nge Autoriteti i Konkuresces per nxitjen e nje mjedisi konkurues dhe rritjen e ndergjegjesimit te publikut per perfitimet nga konkurenca.

Puna e Autoritetit të Konkurrencës në procesin e advokatisë së konkurrencës per vitin 2006 është fokusuar kryesisht në:

A. Komentimin e rregullave legjislative dhe interpretative- p.sh përshkrimi i thjeshtësuar i rregullave me synimin per ti bere ato sa me te kuptueshme dhe te prekshme per ndermarrjet, duke pergatitur njoftime per dukuritë antikonkurrese.

B. Ndërmarrjen e hetimeve te analizave paraprake-p.sh identifikimi dhe eliminimi i atyre dukurive ne fusha te seleksionuara, të cilat japin cdo dite te mira te perdorshme dhe sherbime.

C. Politika vendimore-p.sh duke kuptuar se si duhet qenë të hapur per te perdorur lehtesirat, si një element të rëndësishëm për mbledhjen e evidencave ne ceshtjet e dukurive te kartelit, abuzimit me poziten dominuese,etj

D. Promovimi i njohurive per konkurrencen-p.sh Komunikimi me administraten qendrore dhe vendore, biznesmenët dhe konsumatorët, duke dhene mesazhe te qarta dhe shpjeguese per arsyet, mekanizmin dhe rezultatet e ketyre dukurive ne treg, si dhe metodat e kunderveprimit ndaj tyre nga ana e Autoritetit te Konkuresces.

Njëkohesisht ne zbatim te Ligjit “Per Mbrojtjen e Konkuresces”, Autoriteti ne permbushje te ketij roli te tijit, u drejtohet gjithmone organeve qendrore dhe vendore te administrates shteterore qe te depozitojne prane tij te gjitha projekt-aktet juridike, te cilat mund te permbajne elemente te kufizimit ose te shtremberimit te konkuresces ne treg. Per kete perpiqet te gjeje gjuhen e perbashket me keto organe qe ky mision i tij te realizohet, jo thjesht si qellim ne vetevhte i evidentimit te Autoritetit dhe si detyrim ligjor i ketyre organeve, por si ndergjegjesim i tyre se kjo procedure eshte nje nga me te favorshmet dhe te domosdoshmet per te filtruar aktet juridike nga kufizimet dhe deformimet e konkuresces.

Gjatë vitit 2006 Autoriteti i Konkuresces ndermorri nje sere veprimtarish ne kuader te zhvillimit te kultures se konkuresces. Nder me te rendesishmet mund te radhisim disa Seminare në qytetet kryesore të vendit dhe Konferencen Rajonale te Konkuresces në Tiranë.



Konferenca
Rajonale e
Konkurrencës

26

Me mbështetjen e programit CARDS rajonal 2003 u zhvillua ne Ministrine e Drejtesise ne Mars te vitit 2006 Seminari per te Drejten e Konkurrences, vendase dhe evropiane, me gjyqtare, prokurore dhe punonjes te organeve te “pushtetit te trete”.

Me mbështetjen e programit CARDS 2002 u organizuan dy seminare rajonale ne Durres dhe Vlore, respektivisht ne muajt Maj dhe Qershor, me pjesmarrjen e të zgjedhurve dhe “aktorëve” vendorë, per rritjen e ndjeshmerise së grupeve të interesit për çështjet e konkurrencës. Ne keto seminare u paraqit ligji 9121, date 28. 07. 2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe u evidentua roli i Autoritetit te Konkurrences në vendosjen e konkurrences ne treg, si faktor në mbarësinë ekonomike të shoqërisë.

Per 6-mujorin e pare te vitit qe shkoi veprimtaria me e rendesishme ishte Konferenca Rajonale e Konkurrences e zhvilluar ne Tirane. Ne te moren pjese delegacione te autoriteteve simotra te Konkurrences te vendeve te rajonit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Konkurrencës në Komisionin Ev-

ropian si dhe vendet antare të Rrjetit Nderkombetar te Konkurrences, ku bën pjesë edhe institucioni yne.

Konferenca në konkludim permbushi me se miri misionin e saj per rritjen dhe forcimin e kultures se konkurrences ne vend dhe me gjere, duke mundesuar shkembimin ndersjellte te pervojave perkatese.

Në drejtim të një roli më aktiv dhe më të njohur nga publiku, Autoriteti i Konkurrencës ndërmorri një sërë hapash për rritjen e transparencës së vendimeve të Komisionit të Konkurrencës dhe çështjeve të tjera të lidhura me këtë fushë.

Të gjitha vendimet e Komisionit janë publikuar në kohë reale në faqen zyrtare të internetit⁶ dhe i janë shpërndarë medias. Çështjet e konkurrencës janë parë gjithnjë e me më shumë interes nga gazetarët duke gjetur hapësira më të mëdha si në edicionet e lajmeve në mediat elektronike ashtu dhe në faqet e gazetave.

Autoriteti i Konkurrencës gjithashtu ka qënë aktiv në reagimet e tij publike për rastet e shkeljes, kufizimit apo pengimit të konkurrencës, duke përballur qëndrimet e tij me qëndrimet e aktorëve të tjerë. Pjesëmarrja direkte në media, dhe nëpërmjet saj në publik, nëpërmjet intervistave, shkrimeve apo debateve në studio ka çuar në një stad të ri marrëdhëniet publike të Autoritetit të Konkurrencës.

⁶ www.caa.gov.al

VI. Veprimtaria ekonomike e Autoritetit të Konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2006 ka zbatuar me korektësi kërkesat e Ligjit nr 9464, datë 28.12.2005 “ Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006” në lidhje me përdorimin e fondeve buxhetore

Administrimi i vlerave materiale e monetare është konsideruar një fushë e rëndësishme e punës tonë duke zbatuar me korektësi të gjitha aktet ligjore e nënligjore dhe normativat në përdorimin e fondeve buxhetore. Puna në sektorin e financës është e lidhur me operacionet financiare , si dhe ndjekjen dhe mirëadministrimin e shpenzimeve buxhetore dhe investimeve të cilat janë të lidhura me veprimtarine e institucionit. Gjithashtu, ajo ka siguruar të dhëna për veprimtarin financiar, si dhe ka përcaktuar e ndjekur realizimin e shpenzimeve, të ardhurat, rritjen e aktiveve të institucionit. Në tërsinë e vetë ky sektor ka ndikuar në përmirësimin dhe arritjen e objektivave dhe detyrave që ka institucioni jonë.

Një përmbledhje e treguesve buxhetorë të vitit 2006 paraqiten si me poshtë:

Të dhënat financiare tregojnë një realizim prej 94.8 % ose 1.663 mijë lekë më pak se sa programimi i fillimit të vitit.

VI.1. Fondi i pagave dhe kontributi i sigurimeve shoqërore

Fondi i pagave i planifikuar për Autoritetin e Konkurrencës ishte 20.000 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 19.317 mijë lekë ose 96.5 % me një diferencë më pak nga programimi prej 683 mijë lekë. Ky mosrealizim ka ardhur nga mungesa e numrit të punonjësve gjatë vitit dhe kryesisht në 6 mujin e parë të vitit ku disa vende në strukturën organike të vitit kanë qenë të pa plotësuara. Gjatë realizimit të këtij elementi buxhetor janë zbatuar kërkesat e VKM nr 711, datë 27.12.2001, të VKM nr 450, datë 14.06.2006 dhe të Ligjit nr 9584 datë 17.07.2006 “ Për pagat, shpërbimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj. Gjithashtu, janë ndaluar dhe derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore, shendetësore dhe tatimi i pagës për çdo punonjës sipas udhëzimeve përkatëse.

Nr	Emërtimi	Plan	Fakt	Deviacion	në %
1	Fond page, kontribute Sig. Shoq.	20.000	19.317	- 683	96.5
2	Materiale dhe shërbime të përg.	10.300	9.332	- 968	90.6
3	Investime	2.000	1.988	- 12	99.4
TOTALI		32.300	30.637	- 1.663	94.8

VI.2. Materiale dhe shërbime të përgjithëshme

Për materiale dhe shërbime të përgjithëshme ishin parashikuar 10.300 mijë lekë, të cilat janë realizuar 9.332 mijë lekë ose 90.6 % , me një diferencë me pak nga plani prej 968 mijë lekë. Ky mosrealizim ka ardhur kryesisht nga fondet e pa përdorura për mjetete e transportit ku janë shpenzuar më pak 346 mijë lekë për karburant e pjesë këmbimi. Më pak se programi është shpenzuar për telefoni fikse, energji elektrike, njoftimet e publikimit, udhëtim e dieta, posta e shërbime ,etj.

28

Gjatë vitit 2006 i është kushtuar rëndësi zbatimit të ligjit për dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare. Në blerjet me vlera të vogla janë zbatuar më korrektësi kërkesat e ligjit nr 7971, datë 26.07.1995 “ Për Prokurimin Publik” dhe për blerjet tjera mbi kufirin 300 mijë lekë janë zhvilluar proceset e tenderimeve konforme kërkesave të dispozitave ligjore, gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit.

VI.3. Mbi realizimin e investimeve

Për investimet nga 2.000 mije leke te planifikuara ne fillimin e vitit jane realizuar 1.988 mije leke ose 99.4 % me nje diferences nga parashikimi prej 12 mije leke. Fondet e përdoru-

ra per investime jane kryesisht per paisje e orendi per zyra, kompjutera e paisje kompjuterike etj. te nevojshme per krijimin e kushteve te punes se punonjesve te administrates se Autoritetit te Konkurrences.



VII. Bashkëpunimi me institucionet dhe entet rregullatore

Autoriteti i Konkurrencës gjatë veprimtarisë ka vlerësuar si mjaft të rëndësishëm zhvillimin e marrëdhënieve me institucionet e administratës publike qëndrore dhe vendore në përgjithësi dhe entet rregullatore në veçanti. Ky bashkëpunim synon vlerësimin e barrierave si dhe të shkallës së pengimit apo kufizimit të konkurrencës që lidhet me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në këtë kontekst, institucioneve publike dhe enteve rregullatore iu është kërkuar që çdo akt juridik i dalë nga këto struktura që prek konkurrencën të marrë në konsideratë mendimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Enteve rregullatore nëpërmjet funksionimit të tyre kanë një rol të rëndësishëm në zbatimin e politikave pro-konkurrese në sektorët përkatës, nëpërmjet rregullimit të hyrjes në treg (duke hequr diskriminimin e hyrjes në treg) si dhe rregullimit ekonomik. Kjo veprimtari ka impakt të drejtpërdrejtë në konkurrencë. Në këtë kontekst lind ndërthurja e roleve të Autoritetit të Konkurrencës si institucioni që siguron mbrojtjen e konkurrencës në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe Enteve Rregullatore si institucione që sigurojnë zbatimin e rregullave të konkurrencës në sektorët e rregulluar. Për këtë qëllim, në Nenin 70, pika 2 e ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, përcaktohet se Autoriteti i Konkurrencës mund të bëjë rekomandime në lidhje me barrierat në rregullimin ekonomik dhe administrativ.

Format e bashkëpunimit janë përcaktuar në “Memorandumet e Mirëkuptimit” të Autoritetit të Konkurrencës dhe Enteve Rregullatore, në zbatim të kuadrit ligjor përkatës, të cilat synojnë institucionalizimin e marrëdhënieve nëpërmjet vendosjes së parimeve bazë për shkëmbimin e informacionit në zbatim të kuadrit ligjor përkatës, shkëmbimit të eksperiencës, trajnimeve të përbashkëta, krijimit të grupeve të përbashkëta për çështje të caktuara, ndërtimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit midis institucioneve respektive, etj.

Gjatë vitit 2006 u forcuan marrëdhëniet midis Autoritetit të Konkurrencës dhe Enteve Rregullatore nëpërmjet nënshkrimit të “Memorandumeve të Mirëkuptimit” me institucione të tilla si KKRT, AMF, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe janë përfunduar draft/memorandumet e mirëkuptimit, të cilat priten të nënshkruhen, me ERE, ERU, ERT, Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, INSTAT-in etj.

Duhet theksuar se kjo është një mënyrë shumë efektive për të shkëmbyer përvojë dhe informacion, për të prekur më nga afër dhe për të zgjidhur problemet aktuale rregulluese të ndryshme.

VIII. Synimet kryesore të punës për vitin 2007

VIII.1. Përmirësimet e aspekteve organizative

Autoriteti i Konkurrencës synon të funksionojë gjatë vitit 2007 e në vijim sipas një strukture të re organizative dhe më të plotë si në formën e burimet njerëzore dhe ato financiare. Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 10, pika 1 dhe nenit 15 të ligjit nr.9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, me propozimin e Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financën, Kuvendi miraton strukturën e re të Autoritetit të Konkurrencës.

Duke synuar rritjen e produktivitetit, Autoriteti i ka kushtuar rëndësi plotësimit të Sekretariatit me personelin e nevojshëm, Për më tepër synohet të përmirësohet niveli i profesionalizmit duke iu përafuar standardeve të Autoriteteve homologe.

Nëpërmjet strukturës së re organizative i kushtohet një rëndësi e madhe mbikqyrjes së tregut në zbatim të shtyllave kryesore të ligjit “Për mbrojtjen e Konkurrencës” sipas përcaktimeve të praktikave antikonkurruese dhe duke u mbështet-

tur në eksperiencën e vendeve antare në BE ose vendeve në procesin e antarsimit.

Trajnimi dhe kualifikimi i personelit merr një rëndësi të veçantë për rritjen e efikasitetit të institucionit. Në këtë kuadër do të punohet me organizma të rëndësishëm si OECD, Drejtorinë e Përgjithshme të Konkurrencës në Komisionin Evropian, Rrjetin Ndërkombëtar të Konkurrencës, autoritetet simotra dhe donatorë të tjerë për të zhvilluar një proces të plotë të trajnimit të stafit me praktikatat dhe kodet më të mira në fushën e konkurrencës.

VIII.2. Plotësimi i kuadrit ligjor në kuadër të zbatimit të MSA

Miratimi i akteve nënligjore nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, që lidhen me plotësimin e rregulloreve të nevojshme për funksionimin e plotë të tij, sipas standardeve që zbatohen në vendet e Bashkimit Evropian, është një nga detyrat themelore për vitin 2007. Nisur nga detyrimet e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2007 në kuadër të MSA-së të kthyer në të tillë me VKM nr.463, datë 05.07.2006 “Për zbatimin e Planit Kombëtar të Perditësimit të Legjislacionit, është parashikuar përkthimi, përshtatja dhe miratimi i dy rregulloreve të brendshme të Autoritetit. Këto rregullore do të hartohen duke u bazuar

plotësisht në rregulloret homologe të BE-së. Konkretisht është planifikuar përshtatja e Rregullores (CE) nr. 139/2004 date 20.01.2004, si dhe Rregullores (CE) nr.802/2004, date 07.04.2004.

Përveç këtij detyrimi me akt normativ të ekzekutivit, Autoriteti i Konkurrencës ka planifikuar që të përgatisë gjatë këtij viti, në raport edhe me rastet e grumbulluara, Komentarin shpjegues të Ligjit "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Miratimi i këtyre akteve do t'i shërbejë njohjes dhe zbatimit me të mirë të ligjit të mësipërm, konsolidimit të kulturës së konkurrencës si dhe advokatinë e saj.

Autoriteti i Konkurrencës në punën e tij për vitin që sapo ka nisur do të përqëndrohet në detajimin dhe saktësimin e procedurave hetimore. Nga ky këndvështrim është menduar që në përputhje dhe me Politikën Kombëtare të Konkurrencës do të përcatohen taktikat që do të ndiqen këtë vit duke mundësuar hartimin e një "Metodologjie të Procedurave Hetimore të Konkurrencës".

Gjatë këtij viti Autoriteti synon të luajë një rol më aktiv gjatë procesit të amendimeve të ligjeve dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, në këndvështrimin e së drejtës së konkurrencës.

VIII.3. Studimi i tregjeve dhe hetimi i praktikave potenciale antikonkurruese

Gjatë vitit 2007 Autoriteti i Konkurrencës do të ridimensionojë strukturën e analizës dhe studimit të tregut duke krijuar një sektor të ri, të pavarur nga drejtoritë, por në funksion të të gjithë proceseve të hetimit dhe analizimit të kushteve të tregut për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

Sektori i Analizës dhe Studimit të tregut do të fillojë menjëherë punën për ngritjen e një databese të dhënash për sektorët kryesorë të ekonomisë dhe me fokus të veçantë në sektorët ku vihen re deformime të konkurrencës, fiksime çmimesh, barriera hyrëse në treg, marrëveshje të ndaluara apo abuzime me fuqinë në treg.

Më pas ky sektor do të kalojë në një stad të ri, atë të sinjalizimit të sektorëve të tjerë të Sekretariatit për praktikën antikonkurruese të tregut dhe do të ndihmojë me analizën e tij për evidentimin e pozitës dominuese të një shoqërie në treg për të kaluar më pas në hetime më të thelluara nëse është abuzuar ose jo me këtë pozitë.

Një shfaqje e re e tregut shqiptar është prirja drejt reduktimit deri në eliminim të konkurrencës nëpërmjet marrëveshjeve të ndaluara ndaj dhe ky sektor nëpërmjet analizës së fakteve të siguruara nga inspektorët, do të japë

rekomandimet përkatëse për Sekretariatën dhe Komisionin për ndërprejen e këtyre marrëveshjeve dhe marrjen e masave në zbatim të ligjit.

Edhe proceset e bashkimit apo përqëndrimit të ndërmarrjeve do të jenë në fokusin e analizës së kushteve të tregut për të parë ndryshimet që ndodhin në strukturën e sektorit ku ndodh përqëndrimi/bashkimi dhe për të parë efektet në konkurrencë.

VIII.4. Ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e konkurrencës

Në fund të vitit 2006 Komisioni i Konkurrencës pas një pune disamujore dhe pas marrjes së vërejtjeve dhe sugjerimeve të institucioneve/enteteve të lidhura me çështjet e konkurrencës, miratoi Politikën Kombëtare të Konkurrencës. Por sfida më e madhe mbetet zbatimi në praktikë i angazhimeve të marra në kuadër të dokumentit dhe një bashkëpunim më i madh me të gjithë aktorët dhe faktorët e tregut për zbatimin me efikasitet të politikës kombëtare të konkurrencës.

Dokumenti vlerëson se një ndër rrugët e rëndësishme për mbrojtjen e konkurrencës së lirë, efektive në treg, vlerësohet krijimi një kulture konkurrence në mjedisin shqiptar. Pavarësisht krijimit të Autoritetit të Konkurrencës dhe përqasjes me legjislacionin evropian të konkurrencës, në Shqipëri akoma mungon një kulturë konkurrence në të gjitha nivelet e ekonomisë, duke përfshirë hartimin e politikave publike, komunitetin e biznesit dhe publikun e gjerë.

Një drejtim i rëndësishëm për realizmin e këtij funksioni është vetë rritja e kulturës së konkurrencës dhe kapaciteteve të stafit të Autoritetit për të zbatuar ligjin dhe për të interpretuar vendimet sipas përvojës dhe standarteve ndërkombëtare. Thelbin, për realizmin e këtij funksioni, e përbëjnë komunikimi me institucionet e tjera, komunitetin e biznesit, publikun, lidhur me veprimtarinë e Autoritetit në tërësi dhe vendimmarrjen për zbatimin e ligjit në veçanti.

Autoriteti do të organizojë sondazhe periodike me komunitetin e biznesit dhe publikun mbi kuptimin dhe problematiken e zbatimit të konkurrencës në tërësi dhe ligjit për mbrojtjen e konkurrencës në veçanti, me synim ndërtimin e një dialogu efektiv me ta.

Media konsiderohet si partner i rëndësishëm në përçimin e saktë të politikës së konkurrencës të aktorët e tregut. Nëpërmjet kanaleve të komunikimit të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet medias,



Autoriteti i Konkurrencës do të mundohet të përçojë mesazhet te komuniteti.

VIII.5. Forcimi i bashkëpunimit me institucionet dhe Entet Rregulatore.

Autoriteti i Konkurrencës do të jetë i angazhuar në forcimin e bashkëpunimit dhe vendosjen mbi baza institucionale të këtij bashkëpunimi me Entet Rregulatore.

Nenshkrimi i memorandumëve të mirëkuptimit synon nxitjen e konkurrencës nëpërmjet bashkëpunimit konkret dhe bashkërendimit të posaçëm me Entet Rregulatore. Për vitin 2007 është parashikuar nënshkrimi i Memorandumëve të Mirëkuptimit me institucione të tilla si: me Entin Rregullator të Ujit, me Entin Rregullator të Telekomunikacionit, me Insitutin e Statistikave, me Zyrën e Mbrojtjes së Konsumatorit, me Zyrën e Mbrojtjes së Qytetarit, me Bankën e Shqipërisë, me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Energjitikës, etj... Qëllimi i nënshkrimit të tyre fokusohet në shkëmbimin e informacioneve dhe të eksperiencës, rritjen e transparencës, forcimin e kapaciteteve, trajnime të përbashkëta, etj.

VII.6. Konsolidimi i marrëdhënieve ndërkombëtare të Autoritetit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të nenit 71 të ligjit "Për mbrojtjen e

konkurrencës" do të thellojë bashkëpunimin me autoritetet simotra nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.

Autoriteti i Konkurrencës po bashkëpunon me strukturat e Komisionit Evropian në fushën e konkurrencës, si Drejtorinë e Përgjithshme të Konkurrencës duke ndjekur zhvillimet më kryesore në këtë fushë.

Objektivi ynë është që të kthejmë në partnershipe reale në nivel ekspertësh e specialistësh rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare të konkurrencës. Eksperienca e nisur me rrjetin rajonal të Autoriteteve të Konkurrencës do të thellohet në drejtim të bashkëpunimit edhe me Autoritete fqinje të vendeve antare në Bashkimin Evropian.

Në të ardhmen Autoriteti i Konkurrencës do të bashkëpunojë me autoritetet e huaja simotra duke formalizuar bashkëpunimin nëpërmjet memorandumëve të mirëkuptimit por edhe në marrjen e hapave konkrete në mbështetje të ligjeve përkatëse të konkurrencës për të njëjtën shkëlqje ose në tregje që kanë prerje.

Autoriteti i Konkurrencës do të jetë aktiv nëpërmjet prezantimeve të rasteve në tavolinat e rrumbullakta apo konferencave kombëtare e ndërkombëtare në fushën e konkurrencës të organizuar nga OECD, organizma të tjerë ose autoritetet simotra.